ID Personale: Personal ID: Licni ID:	811488859
Adresa: Address: Adresa:	Magj.Ferizaj - Prishtinë, . Talinoc i Muhaxherëve Ferizaj, Kosova
Përgjegjësia: Liability: Odgovornost:	
Pjesa në pronë: Owned part: Deo o vlasnistvu:	2,830,000.00€
Data regjistrimit: Registration date: Datum registracije:	

☒ Aksionar / Shareholder / Akcionarsko ☐ Aksionar i privilegjuar / Privileged shareholder/ Privilegovani akcionar



Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Personat e autorizuar / Authorized participants / Ovlascene lice

Emri: Name: Ime:	Shkelzen Heta
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1004517098
Pozita e punës: Job position: Radno mesto:	Drejtor menaxhues
Adresa: Address: Adresa:	Varosh Varosh Ferizaj, Kosova
Autorizimet: Authorizations: Autorizacije:	Sipas ligjit dhe statutit.

Emri: Name: Ime:	Kemajl Rushiti
ID Personale: Personal ID: Licni ID:	1005077938
Pozita e punës: Job position: Radno mesto:	Agjent I Regjistruar
Adresa: Address: Adresa:	Sazli Sazli Ferizaj, Kosova
Autorizimet: Authorizations: Autorizacije:	



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR	
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org. Jedinice Org. Unit	50
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	5440-2/14
Nr. I faqeve Br. Stranica No. Pages	04
Data : Datum Date	03.10.2015
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	28.01.2015
REFERENC-Ë:	14/5440/1 -540/DMM
PËR/ZA/TO:	„Hib Petrol“ Sh.p.k., Talinoc i Muhaxherëve Ferizaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 14/5440/1 -540/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për pëlqim mjedisor për Stacionin e Karburanteve në Llapllasellë, Graçanicë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 90. të LPA (Nr.02/L-28), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Kompanisë „Hib Petrol“ Sh.p.k., Talinovc i Muhaxherëve Ferizaj, për pëlqim mjedisor për Stacionin e Karburanteve në Llapllasellë, Graçanicë.

Mënyra e operimit është e përshkruar në vijim (Arsyetim) dhe është e obligueshme për palën.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së dokumentacionin e dorëzuar të „Hib Petrol“ Sh.p.k. Talinovc i Muhaxherëve Ferizaj për pëlqim mjedisor për Stacionin e Karburanteve, në ngastrat kadastrale P- 73414042-01888-4, P- 73414042-01888-12, nr. i lëndës së Çertikatës, 2390-2014 dhe 2391-2014 Zona kadastrale Llapllasellë, komuna e Graçanicës.

Në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-214 për VNM , është mbajtur debati publik, dhe me këtë rast, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i **jep pëlqim mjedisor**, për ndërtimin e stacionit të karburanteve për rezervarët me kapacitet 1x60 m³ (2x30 m³) për benzinë dhe 1x60 m³ (2x30 m³) për naftë si dhe rezervarit me kapacitet prej 15 m³ për gaz (propan- butan), nën kushtet si vijon:

- Të ndërtohet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave sipërfaqësore, nga të gjitha sipërfaqet funksionale dhe ujërave të zeza

Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



(seperator i për vajra dhe gropa septike) adekuate me standarde dhe konform ligjit.

- Të vendoset sistemi i gypave për ftohjen me anë të ujit në rezervuarin me lëndë djegëse të gazta për pengimin e ndikimit direkt, të nxehtësisë gjatë sezonës së verës.
- Të betonohet dhe izohet platoja ku janë të vendosur rezervarët e derivateve.
- Të betonohet dhe izohet platoja e sipërfaqeve operacionale.
- Të bëhet vendosja e kontejnerëve të posaçëm për deponimin e mbeturinave të ngurta në mënyrë që ambienti rreth lokalitetit të jetë çdo herë i pastër.
- Rregullisht të pastrohet seperatori dhe gropa septike.
- Të bëhet monitorimi i ujit para shkarkimit të tij.
- Të bëhet mbjellja me druj dekorativ dhe barishte e sipërfaqeve të pa gjelbëruara.
- Të përgatitet dhe implementohet plani akcional për raste aksidenti.
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (anulohet).

Pëlqimi Mjedisor është kusht për marrjen e Lejes Ndërtimore.

Paraprakisht operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj dhe të pajiset me Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen për dy vite konform nenit 25 të Ligjit për VNM Nr. 03/L-214.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.:14/5440/1 - ZSP/18/15 datë: 28.01.2015

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.



	ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА KOMUNA E GRAÇANICËS MUNICIPALITY OF GRAÇANICA ОДЕЉЕЊЕ ИНСПЕКЦИЈЕ DEPARTAMENTI I INSPEKSIONIT DEPARTMENT OF INSPECTION 4392/23	РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА KOMUNA E GRAÇANICËS MUNICIPALITY OF GRAÇANICA 11 AUG 2023
---	---	---

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 2, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe paragrafi 4 nenit 21, paragrafi 1, nenit 22, nenit 26 paragrafi 1, nenit 37, nenit 44, nenit 46-48 të Ligjit të Procedurës e Përgjithshme Administrative nr.05 /L-031, nenit 3 paragrafi 1 pika 1.7 të Ligjit nr. 04/L/186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoriatin dhe Mbikqyrjen e Tregut 03L/181 nenit 38 paragrafi 1 pika a) të Ligjit për Tregun e Brendshëm nr. 2004/18, nenit 8 paragrafi 8.1 pika p) Shtojcës I Kapitullit XII neni 1 pika 1, të Statutit të Komunës së Graçanicës 6320/15 nga data 22.10.2015, nenit 83 të Rregullores komunale mbi kushtet themelore higjieniko-tekniko-sanitare nga aspekti i hapsirave punuese, stabilimenteve, pajisjeve, mbrojtjes në punë, dhe mbrojtjes së mjedisit duke vepruar sipas kërkesV 943/23” të parashtruar nga personi autorizuar: Etrit Ademaj ,me proqes verbal 01/23-4 nga “HIB PETROL”SH.P.K. brenda detyrave dhe përgjegjësi të tij merr këtë:

A K T V E N D I M

I Subjekti afarist “HIB PETROL”SH.P.K..ne Magjistralka PR-FER,ana e djath,numri parcelles:P-73414042-01888-12,P-73414042-01888-14;P-73414042-01888-16;P-73414042-01888-4, me seli në Komune e Graçanices,,me numri unik identifikues 810662834 me sipërfaqen prej 10563m2,nga pronari:BUCALIU KUJTIM me NP 11004592502,**I PLOTËSON KUSHTET MINIMALE TEKNIKE** për të kryer veprimtarinë :4730 Tregtia me pakice e karburantit për automjete në dyqane të specializuara

II Ky vendim hyn në fuqi, ditën e miratimit të tij.

A R S Y E T I M

07.07.23. personi i autorizuar i subjektit afarist, i cekur në paragrafin I të dispozitivit të aktvendimit, dorëzoi kërkesën nr. **V 943/23** për kontrollimin e plotësimit të kushteve teknike , për kryerjen e veprimtarisë .

Pas shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura dhe kontrollit të objektit në vendin e ngjarjes që është kryer nga Komisioni komunal, inspektori i tregut komunal, duke vepruar si anëtar i Komisionit dhe në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tij, në përputhje me dispozitat e nenit 3 paragrafi 1 pika 1.7, të Ligjit nr.04/L/186 për ndryshimet dhe për plotësi 01/23-4 nga 12.07.23. është konstatuar se **objekti në fjalë i plotëson kushtet minimale teknike për ushtrimin e veprimtarisë në fjalë**, të parapara me Ligjin dhe Rregulloren komunale e cila e rregullon fushën në fjalë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në një afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa mund të paraqitet përmes Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Graçanicës për Inspektorin kryesor të inspektoratit të tregut – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Subjektit të aktivitetit afarist
- Arkivit.

Procedurën e udhëhoqi:

Inspektori i tregut, Zana Pljakic

E aprovon:

Drejtori i inspektionit, Jelena Stojanović



	ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА KOMUNA E GRAÇANICES MUNICIPALITY OF GRAÇANICA ОДЕЉЕЊЕ ИНСПЕКЦИЈЕ DEPARTAMENTI I INSPEKSIONIT DEPARTMENT OF INSPECTION	 4392/23 11 AUG 2023
---	--	--

Na osnovu člana 17. stav 1.tačka s) Zakona o lokalnoj samoupravi br.03/Z-040; člana 2. stav 1. podstav 1.1 i stav 4. čl. 21 stav 1 čl. 22, člana 26 stav 1. čl. 37, člana 44, člana 46-48 Zakona o opštoj administrativnoj proceduri br. 05/Z-031; člana 3. stav 1. tačka 1.7. Zakona br. 04/Z-186 o izmenama i dopunama Zakona o inspektoratu i nadzoru tržišta 03/Z-181 član 38. stav 1. tačka a) Zakona o Unutrašnjoj trgovini br. 2004/18; člana 8.stav 8.1.tačka p), Priloga I poglavlja XII stav 1. tačka 1. Statuta opštine Gračanica 6320/15 od 22.10.2015; člana 83. opštinskog pravilnika o osnovnim – tehničkim uslovima u pogledu radnih prostorija, postrojenja, opreme, zaštite na radu i zaštite životne sredine; rešavajući po zahtevu br. V 943/23, od 07.07.23. podnetog od strane ovlašćenog lica "HIB PETROL"SH.P.K., cije je ovlašćeno lice Etrit Ademaj, zapisnikom 01/2023-4. od dana 12.07.23. god. u okviru svojih zadataka i nadležnosti donosi:

R E Š E N J E

I Poslovni subject "HIB PETROL"SH.P.K. ciji je vlasnik BUCALIU KUJTIM sa adresom: magistrala Pristina-Uroševac, kružni tok kod skretanja za Lipljan, desna strana sa brojem NP 11004592502 sa brojem biznisa 810662834, kat.parcelama: P-73414042-01888-12; P-73414042-01888-16; P-73414042-01888-14 I P-73414042-01888-4 I površinom 10563m² **ISPUNJAVA MINIMALNE TEHNIČKE USLOVE:** za obavljanje delatnosti: 4730-Trgovina na malo motornim gorivima I mazivima u specializiranim prodavnicama

II Ovo rešenje stupa na snagu, danom njegovog donošenja.

07.07.2023. godine, ovlašćeno lice poslovnog subjekta is stava I dispozitiva rešenja, podneo je zahtev br. V 943/23 za kontrolu ispunjenosti tehničkih uslova, za obavljanje delatnosti.

Uvidom u dostavljenu dokumentaciju i kontrolom objekta na licu mesta, izvršenom od strane opštinske Komisije, opštinski tržišni inspektor, postupajući kao član Komisije u okviru svojih zadataka i nadležnosti, u skladu sa odredbama člana 3. stav 1.tačka 1.7, Zakona br. 04/L/186 o izmenama i dopunama Zakona o inspektoratu i nadzoru tržišta 03/L/181, zapisnikom tržišnog inspektora br.01/23 -4 od dana 12.07.2023.godine konstatovano je, da objekat ispunjava minimalne tehničke uslove za obavljanje navedene delatnosti, propisane Zakonom i opštinskim pravilnikom koji reguliše navedenu oblast.

Na osnovu iznetog, donosim odluku kao u dispozitivu.

PRAVNO UPUTSTVO:

Protiv ovog rešenja nezadovoljna strana, može izjaviti žalbu, u roku od 30 dana od dana prijema istog. Žalba se izjavljuje, preko Odeljenja inspekcije Opštine Gračanica, za Glavnog Inspektora tržišnog inspektorata - Ministarstva trgovine i industrije. Žalba na rešenje ne zadržava izvršenje.

Dostaviti:

- Privrednom subjektu,
- Arhivi

Postupak vodio

Tržišni inspektor, Zana Pljakic

Odobrio

Direktor inspekcije, Jelena Stojanović





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo
Unutrasnjih Poslova /Ministry of Internal Affairs
Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog
Upravljanja/Emergency Management Agency



Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Departamenti i Parandalimit, në mbështetje të Nenit 12 dhe 13 të Ligjit për mbrojtje nga zjarri 04/L-012 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/10 gushtë 2011) si dhe Nenin 44, 50 dhe 86. LPA, nr. 05/L-031, duke vendosur sipas kërkesës nr.644/2019 lëshon këtë:

P Ë L Q I M

“Hib Petrol” SH.P.K. me seli në Ferizaj i epet pëlqimi në dokumentacion investiv teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri për pikën e shitjes së derivateve të naftës me kapacitet të rezervuarve: V=29990, 29988, 25110 dhe 29921 litra naftë dhe benzinë, si dhe i gazit të lëngëzuar naftor V=15.000 litra, ky objekt gjindet në kuader të parcelav kadastrale;01888-12, 01888-14, 01888-4, certifikata e njësisë kadastrale;P-73414042-01888-12, -01888-14, -01888-4, zona kadastrale Llapnasella, Komuna **Gračanicë**.

Pala është e obliguar qe të respektoj të gjitha masat e parapara nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri sipas rregullave teknike në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

A r s y e t i m

“Hib Petrol” SH.P.K. me seli në Ferizaj ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent për dhënien e pëlqimit në dokumentacionin investiv teknik për pikën e shitjes së derivateve të naftës me kapacitet të rezervuarve: V=29990, 29988, 25110 dhe 29921 litra naftë dhe benzinë, si dhe i gazit të lëngëzuar naftor V=15.000 litra, ky objekt gjindet në kuader të parcelav kadastrale;01888-12, 01888-14, 01888-4, certifikata e njësisë kadastrale;P-73414042-01888-12, -01888-14, -01888-4, zona kadastrale Llapnasella, Komuna Graçanicë.

Kërkesës pala i ka bashkangjitur: certifikatën e biznesit, certifikatën e njësisë kadastrale, pëlqimin në lokacion nr.97/2013-elaboratin e MNZ dhe dëshminë mbi pagesën e taksave për dalje në terren.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shikimit të dokumenteve, nga ana e komisionit është konstatuar se në dokumentacionin teknik janë përfshirë masat thelbësore për mbrojtje nga zjarri, pala është e obliguar qe të respektoj të gjitha masat e parapara nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri sipas rregullave teknike në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, andaj komisioni ka propozuar për lëshimin e këtij pëlqimi.

Nr. 559/19

Prishtinë;22.10.2019



Alush Beqiri

Drejtori i Departamenti të Parandalimit



Republika e Kosovës
NOTER
EKREM NUHIU
GRAÇANICË

LRP.nr.rend. 2419/2021
Numri i ref.947/2021

K O N T R A T Ë MBI QIRANË

Më tridhjetë qershor dymijë e njëzet e një(30.06.2021), para meje Ekrem Nuhiu, Noter në Graçanicë, paraqiten:-----

1. **z. Luan Likaj(Mustafë)**, i lindur më 28. mars 1969, në Deçan, shtetas i R.Kosovës, bartës i patentë shoferit me nr.DL31075385, me nr.personal 1009516618, i lëshuar nga MPB-së e R.Kosovës, më 06.12.2018, i vlefshëm deri më 05.12.2028, me vendbanim në Prishtinë, Rr.”Isa Kastrati, të cilin me Autorizim Lrp.nr.rend.2235/2021, I datës 22.06.2021, përpiluar dhe vërtetuar nga i njëjti Noter Ekrem Nuhiu në Graçanicë,e përfaqson **z. Drilon Heta**, i lindur më 10.11.1987, në Varosh, shtetas i Republikës së Kosovës, bartës i letërnjoftimit me nr.ID0826272, me nr.personal 1173501486, lëshuar nga MPB-së e R.Kosovës më 30.08.2017, me afat skadimi deri më 29.08.2027, me vendbanim në Varosh, Ferizaj, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në tekstin e mëtejshëm: **në cilësin e qiradhënësit**).-----

2. **z. Jetmir Likaj (Ali)**, i lindur më 05. Shkurt 1981, në Deçan, shtetas i Kosovës, bartës i pasaportës me nr.P00198949, me nr.person.1009956731, i lëshuar nga MPB-së e R.Kosovës, më 03. dhjetor 2012, i vlefshëm deri më 02. dhjetor 2022, me vendbanim në Prishtinë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vërtetuar nga Noteri Jurgen Kuhn në Gjermani, e përfaqson **z. Drilon Heta**, i lindur më 10.11.1987, në Varosh, shtetas i Republikës së Kosovës, bartës i letërnjoftimit me nr.ID0826272, me nr.personal 1173501486, lëshuar nga MPB-së e R.Kosovës më 30.08.2017, me afat skadimi deri më 29.08.2027, me vendbanim në Varosh, Ferizaj, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në tekstin e mëtejshëm: **në cilësin e qiradhënësit**).-----

3. **“MERCHANDISING GROUP” L.L.C.**, me seli në Lapnasellë p.n., Gracanicë, me numër unik identifikues 810151027, e përfaqësuar nga Drilon Heta, drejtor menaxhues, i lindur më datë 10 Nëntor 1987, në Varosh, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar përmes letërnjoftimit me numër personal 1173501486, i lëshuar nga MPB e R. Kosovës, më 30.08.2017, i vlefshëm deri më 29.08.2027, me vendbanim në fsh. Varosh – Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: **në cilësin e qiramarrësit**).-----

Qiradhënësi dhe Qiramarrësi në tekstin e mëtejshëm së bashku referohen si: **Palët Kontraktuese**.-----

Palët Kontraktuese lidhin këtë:-----

KONTRATË MBI QIRANË E PALUAJSHMËRISË-----

1. Qiradhënësit Luan Likaj dhe Jetmir Likaj lëshojnë me qera paluajtshmërinë që është objekt i kësaj Kontrate ndërsa Qiramarrësi “Merchandising Group” L.L.C., merr me qera paluajtshmërinë e cila është objekt i kësaj Kontrate.-----

2. Qiradhënësit janë pronar të ligjshëm të ngastrave kadastrale në të cilat janë të vendosura objektet afariste që së bashku me ngastrat kadastrale përbejnë paluajtshmërinë që është objekt i kësaj Kontrate.-----

NENI 1 – OBJEKTI I KONTRATËS:-----

1.1 Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e paluajtshmërive dhe objekteve afariste të ndërtuara në to për përdorim si pompë për shitjen e derivateve të naftës, restaurant, market dhe autolarje, të cilat gjenden në zonën kadastrale Llapnasellë, të ndërtuara në ngastrat kadastrale me numër të njësisë: -----

P-73414042-01888-12, Z.K. Llapnasellë, në vendin e quajtur “Fusha e Gjerë” me sipërfaqe prej 1250 m2, pjesa e pronës 1/1 në emër të Luan Mustafë Likaj,-----

P-73414042-01888-16, Z.K. Llapnasellë, në vendin e quajtur “Shiroko Polje” me sipërfaqe prej 1950 m2, pjesa e pronës 1/1 në emër të Luan Mustafë Likaj,-----

P-73414042-01888-14, Z.K. Llapnasellë, në vendin e quajtur “Shiroko Polje” me sipërfaqe prej 2397 m2, pjesa e pronës 1/1 në emër të Luan Mustafë Likaj,-----

P-73414042-01888-4, Z.K. Llapnasellë, në vendin e quajtur “Shiroko Polje” me sipërfaqe prej 4966 m2, pjesa e pronës 1/1 në emër të Jetmir Ali Likaj, -----

1.2. Qiramarrësi e ka njoftuar, dhe Qiradhënësi është pajtuar të njejtat parcela të lartëcekura mund ti’a japin me nën-qira te personi i tretë, por duke mos ndryshuar asnjë nga kushtet që janë të cekura në këtë kontratë.-----

1.3. Qiradhënësi është në njohuri dhe pajtohet se të gjitha të drejtat e fituara në këtë Kontratë do të nënkontrakohen tek ndonjë nënqiramarrës në rast se lëshohet me qira nga qiramarrësi.-----

1.4. Qiradhënësit deklarojnë dhe zotohen se nuk rezervojnë asnjë të drejtë në të njëjtën, përpos atyre të parashikuara specifikisht në këtë Kontratë.-----

NENI 2 – KOHËZGJATJA E KONTRATËS:-----

2.1 Kjo Kontratë lidhet për një afat prej dhjetë (10) viteve apo njëqind e njëzet (120) muaj, e cila fillon të rrjedhë nga data 01.07.2021 dhe përfundon me datën 30.06.2031.-----

2.2 Qiradhënësi është i njoftuar dhe pajtohet se Qiradhënësit do të hyjnë në Kontratë të Nën-Qirasë për të njëjtën periudhë kohore me ndonjë ndërrmarje tjetër. Andaj, Qiradhënësit heqin dorë dhe zotojnë dhe



garantojnë se në asnjë rrethanë nuk do të kenë të drejtë të bëjnë shpërndarjen e Kontratës së Qirasë para afatit të parashikuar me paragrafin 1 më lartë. -----

2.3. Pas përfundimit të afatit prej dhjetë (10) viteve nga paragrafi 1 i këtij neni, Qiramarrësi me një njoftim me shkrim prej gjashtë (6) muajve përpara duhet që t'i njoftojë Qiradhënësit për vazhdimin e kontratës së qirasë edhe për **dhjetë (10) vite të tjera**. Në rast të vazhimit të kontratës edhe për dhjetë (10) vite të tjera, kushtet e kësaj kontrate do të negociohen-----

2.4. Palët e kësaj Kontrate konfirmojmë se paluajtshëmritë e identifikuar në Nenin 1 janë në të dhëna me qera tek **"MERCHANDISING GROUP" L.L.C.**, sipas Kontratës së Qirasë. Me hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate, shfuqizohet dhe zëvendësohet çfarëdo marrëveshje paraprake, me gojë apo me shkrim, e cila ka egzsistuar para asaj date. -----

NENI 3 – ÇMIMI I QIRASË DHE KUSHTET E PAGESËS:-----

3.1 Qiramarrësi është i obliguar që Qiradhënësve t'i paguajë në emër të qirasë për paluajtshmërinë e marrë me qira që janë të cekura më lartë shumën mujore të qirasë në vlerë bruto
apo shprehur në shumën vjetore prej -----

Palët bien dakord se nëse nuk paguhet kësti mujor sipas afatit të sipërcekur, ky akt noterial do të jetë titull përmbarues dhe do të përmbarohet nga përmbaruesi privat, sipas ligjit për procedurën përmbarimore NR.04/L-139.-----

Sipas nenit 43. pika 1-6. të LNK.Nr.06/010 ky akt noterial është dokument përmbarimor dhe e ka fuqinë provuese dhe ekzekutuese.-----

3.2. Çmimi i qirasë nga paragrafi 1 i këtij neni është bruto dhe përfshin Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në përputhje me normat e aplikuara.-----

3.3. Qiramarrësi do t'ia ndalë Qiradhënësve nga qiraja bruto mujore e specifikuar në nenin 3.1 dhe 3.2 më lartë shumën e cila do të llogaritet për pagesën e Tatimit mbi Qiranë, e cila vlerë do të llogaritet sipas ligjeve në fuqi. Ndryshimet pozitive apo negative në normën e tatimit në qera në të ardhmen i bartin Qiradhënësit.-----

3.4. Qiramarrësi do të bëjë pagesën e çmimit të qirasë çdo muaj brenda pesë (5) ditëve të para të muajit për qiranë e muajit paraprak, në xhirollogari bankare të Qiradhënësve.-----



3.5. Nëse kjo Kontratë pengohet, kufizohet ose vjen deri tek ndërhyrja substanciale për arsye të ndodhjes së ndonjë ngjarjeje të "Forcës Madhore", qoftë Qiramarrësi ose Qiradhënësit, pas dërgimit të njoftimit për palën tjetër, do të lirohet nga ajo pjesë e detyrimeve për aq kohë sa mund të zgjasë pengimi, kufizimi ose ndërhyrja. Me të përfunduar arsyeja që ka sjellë tek "Forca Madhore" do të rifillojnë obligimet e qiradhënies. Për nevoja të kësaj kontrate "Forca Madhore" nënkupton: zjarrin, tërmetin, vërshimet, tornadon, epidemi apo pandemi të shpallura si rezultat i të cilave ndërprehet apo kufizohet veprimtaria ekonomike e Qiramarrësit, apo fatkeqësi të tjera natyrore, grevave ose pakënaqësive të lidhura me çështje të të drejtave të punës: luftën, konfliktet civile ose forma të tjera të dhunës; ndonjë ligj, shpallje të rendit, rregullore, urdhëresë, veprim, kërkesë ose urdhër të ndonjë agjencie ose organi qeveritar, ose cili do veprim ose rrethanë tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të palëve.-----

NENI 4 – TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E QIRAMARRËSIT:-----


4.1. Qiramarrësi do të paguajë shpenzimet e rrymës, ujit, mbeturinave, shërbimeve telefonike si dhe shërbimeve tjera prej ditës kur i njëjti do të fillojë me punë, ndërsa Qiradhënësit janë të obliguar që të paguajnë të gjitha shpenzimet të krijuara deri në ditën kur Qiramarrësi do të fillojë punën si dhe shpenzimet tjera të cilat nuk janë të krijuara nga Qiramarrësi.-----

4.2. Qiramarrësi do të shfrytëzojë objektin dhe paluajtshmëritë në tërësi për të gjithë sipërfaqen e përshkruar si në nenin 1 të kësaj Kontrate, derisa Qiradhënësit nuk rezervojnë asnjë të drejtë në paluajtshmëri me të cilat mund të cenojë aktivitetin biznesor të Qiramarrësit.-----

4.3. Qiramarrësi ka të drejtë që hapësirën e paluajtshmërisë t'a organizojë sipas nevojave të tij dhe të bëjë ndërtime dhe rindërtime të reja, si mbi ashtu edhe nën sipërfaqen e tokës. Qiramarrësi nuk ka asnjë kufizim sa i përket modelit të projektit, objekteve ndërtimore dhe materialeve të përdorura, apo aspekte tjera. Qiradhënësit detyrohen të japin të gjitha pëlqimet e nevojshme për aplikim për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore sipas kërkesave të organeve publike për këtë qëllim, pa vonesa. -----

4.4. Interieri, investimet e lëvizshme dhe malli i vendosur nga Qiramarrësi apo nën-Qiramarrësi konsiderohen pronë e pronarit respektiv dhe i njëjti me rastin e lirim të paluajtshmërisë të njëjtat do t'i marrë për vete ndërsa ndërtimi i palëvizshëm dhe i pa-demontueshëm i objektit mbetet tek Qiradhënësit.--

4.5. Qiramarrësi apo nën-Qiramarrësi ka të drejtë që në paluajtshmërinë e marrë me qira të vendosë shenja reklamuese (billborda, shpallje, slogane dhe shenja tjera) të kompanisë së tij sipas nevojave të tij



pa pëlqimin paraprak dhe pa lejen e Qiradhënësit.-----

4.6. Qiramarrësi është i obliguar që për pronën të kujdeset si një nikoqir dhe ekonomist i mirëfilltë dhe se ndaj të njëjtave të mos shkaktohet humbje apo ulje e vlerës.-----

4.7. Qiramarrësi ka të drejtë që paluajtshmëritë ose pjesë të paluajtshmërive dhe objekteve të marra me qira, t'i lëshojë me nën-qira personit të tretë, dhe po ashtu nënqiramarrësi ka të drejtë t'i lëshojë me nën-qira tek personat e tretë të cilët janë pjesë dhe partnerë afarist të korporatës pa njoftimin paraprak dhe pa pëlqimin paraprak të Qiradhënësit. Për qëllime të këtij neni, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Qiradhënësit konsiderohet se kanë dhënë pëlqimin për Qiramarrësin që i njëjti të lëshojë paluajtshmëritë e marra me qira sipas kësaj Kontrate me nën-qira apo që t'a transferojë apo cedojë këtë Kontratë tek ndonjë palë e tretë. -----

NENI 5 - TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E QIRADHËNËSVE:-----

5.1. Qiradhënësit garantojnë se janë pronar ligjor të paluajtshmërive të dhëna me qira dhe e garantojnë Qiramarrësin se i njëjti do t'i shfrytëzojë lirshëm, pa asnjë pengesë, ndërprerje apo shqetësim nga Qiradhënësit apo cilido person tjetër fizik apo juridik dhe deklarojnë se janë të gatshëm që t'i paguajnë çdo lloj kompensimi të dëmit apo fitimit të humbur në rast se Qiramarrësi pengohet në shfrytëzim të objektit dhe paluajtshmërive.-----

5.2. Qiradhënësit garantojnë se paluajtshmëritë që jepen me qira janë të lira nga çfarëdo të drejta apo pretendime të palëve të treta apo kufizime të tjera, dhe se këto paluajtshmëri janë pasuri të veçanta të Qiradhënësve, se nuk ekziston ndonjë pretendim pronësor - juridik, dhe se nuk ka ndonjë pengesë tjetër, të regjistruar apo të paregjistruar lidhur me të njëjtat, dhe se Qiramarrësi mund t'i shfrytëzojë lirshëm dhe në mënyrë të papenguar ato.-----

5.3. Nëse Qiramarrësi ka pengesa eventuale në shfrytëzim të paluajtshmërive për shkaqet e përmendura në paragrafin 1 dhe 2 më sipër, apo të tjera, atëherë Qiradhënësit marrin për obligim dhe detyrim që pengesat t'i eliminojë me shpenzime të tyre si dhe Qiramarrësit t'ia kompensojnë dëmin eventual për çdo investim të bërë, fitim të humbur dhe çdo dëm tjetër që parashihet me ligj.-----

5.4. Qiradhënësit nuk marrin përgjegjësi në rast të zgjerimit të rrugës nga organet kompetente shtetërore dhe zvogëlimit të hapësirës së paluajtshmërive, me kusht që të mos pengohen aktivitetet biznesore të

Qiramarrësit.-----

5.5. Qiradhënësit garantojnë Qiramarrësin se do t'i përmbushin detyrimet e parapara me këtë Kontratë në mënyrë strikte sikurse janë parashikuar me këtë Kontratë.-----

NENI 6 – NDËRPRERJA - PËRFUNDIMI I KONTRATËS:-----

6.1. Kjo Kontratë mund të ndërpritet sipas kushteve që vijnë:-----

6.1.1. Kur Kontrata për qira skadon pas afatit të Kontratës dhe Palët Kontraktuese nuk e kanë vazhduar të njëjtën për periudhë tjetër.-----

6.1.2. Me marrëveshjen e të dyja palëve.-----

6.1.3. Nga ana e Qiramarrësit apo Nën-Qiramarrësit në mënyrë të njëanshme në rast se i njëjti pengohet në posedimin e paluajtshmërive sipas kushteve të kësaj Kontrate.-----

6.2. Qiradhënësit nuk kanë të drejtë që t'a shkëpusin këtë Kontratë të qirasë para skadimit të periudhës dhjetë (10) vjeçare -----

6.3. Qiradhënësi është njoftuar dhe është pajtuar se nën-qiramarrësi mund të kërkojë shkëputjen e Kontratës së qirasë nëse i njëjti në bazë të një vlerësimi afarist konkludon se nuk është duke punuar me fitim (punohet me humbje) në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve rresht apo se në periudhat e ardhshme të qirasë nuk pritët që do të punoj me fitim. Asgjë në këtë drejtim nuk lidhet me detyrimet respektive të cilat Qiradhënësi ka ndaj Qiramarrësit sipas kësaj Kontrate.-----

6.4. Në rast të transferimit të pronësisë mbi paluajtshmëritë në persona të tretë, detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë do të jenë detyruese mbi titullarët e rinjë. -----

NENI 7 – EKZEKUTIMI NË RAST TË MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE:-----

7.1. Të gjitha mospajtimet të cilat mund të paraqiten ndërmjet palëve kontraktuese do të zgjidhen me marrëveshje të palëve kontraktuese. Për të gjitha kontestet eventuale kompetente, do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.-----



7.2 Për çështjet të cilat nuk janë parashikuar me këtë kontratë do të zbatohen dispozitat përkatëse të ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

7.3. NOTERI I NJOFTON PALËT SE KONFORM NENIT 22, PIKA 1.3 TË LIGJIT PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE 04/L-139, BOTUAR NË GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, KY AKT NOTERIAL PARAQET TITULL EKZEKUTIV DHE SE GJYKATA APO PËRMBARUESI MUND TË BËJNË PËRMBARIMIN E TIJ VETËM NË BAZË TË KËTIJ TITULLI EKZEKUTIV PA TË NËNSHTRUAR NDONJË PROCEDURE TJETËR.

NENI 8 - TRANSFERIMI I TË DREJTAVE TË PRONËSISË DHE AUTORIZIMET SHITESË:

8.1. Nëse Qiradhënësit i shesin paluajtshmëritë apo transferojnë tërë qiranë e objektit të dhënë me qira, Qiradhënësit duhet paraprakisht të marrin pëlqim nga Qiramarrësi në formë të shkruar, dhe me pas duhet të njoftojë Qiramarrësin lidhur me identitetin e palës së tretë përpara shitjes, transferimit apo bartjes së pronësisë si dhe të pajtohen në lidhje me investimet e bëra dhe mënyrën e kompensimit të këtyre kompensimeve, e poashtu detyrohet ta njoftojë blerësin me një kopje të kësaj Kontrate duke e detyruar që Kontrata të zbatohet edhe nga pronari i ri me të gjitha pikat dhe kushtet siç janë përshkruar në këtë Kontratë.

8.2 Qiradhënësit përmes kësaj Kontrate i japin Qiramarrësit të gjitha autorizimet e nevojshme për qëllime të aplikimit për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore, Certifikatë të Përdorimit, ndryshim/plotësim të kushteve ndërtimore, ndërtime dhe rindërtime të reja, dhe çfarëdo ndryshimi në parcelat të cilat janë objekt i kësaj Kontrate. Konsiderohet se të gjitha autorizimet që lidhen me këto prona i kalojnë Qiramarrësit.

NENI 9 – TATIMET:

9.1 Qiradhënësit do të mbajnë përgjegjësinë për pagesën e tatimeve mbi pronën dhe cilëndo ngarkesë tjetër që biejnë mbi objektin e qirasë, ndërsa pagesa e tatimit në burim të qirasë do të bëhet nga Qiramarrësi i cili do të ndalë - zbres nga shuma bruto e qirasë dhe të njëjtin tatim do të transferojë në llogarinë bankare të Administratës Tatimore të Kosovës.

9.2 Qiramarrësi në fund të çdo viti do t'i lëshojë Qiradhënësit Certifikatë për ndaljen e tatimit në burim për atë vit.

NENI 10 – DOKUMENTET QË I BASHKANGJITËN AKTIT NOTERIAL:-----

1. Certifikata e pronës së paluajtshme dhe kopja e planit;-----
2. Kopja e dokumentit identifikues të Qiradhënësve;-----
3. Kopja e dokumentit identifikues të përfaqësuesit të Qiramarrësit;-----
4. Certifikata dhe informatat e biznesit;-----
5. Fatura e Noterit;-----

NENI 11 – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE -----

11.1. Gjatë përpilimit të këtij akti, dëshmoj se janë respektuar të gjitha dispozitat ligjore të LNK, përkatësisht nenet 33, 36 dhe 38.-----

11.2. Konstatoj se tek palët nuk ka konfuzion apo dyshime rreth këtij akti dhe efekteve të tij juridike, rreth përpilimit të aktit.-----

11.3. Konstatoj se palët kanë dëshmuar identitetin e tyre ashtu siç është shënuar dhe se ata e kanë zotësinë e plotë të veprimit.-----

NENI 12 - LEXIMI I PANDËRPRERË I AKTIT:-----

12.1. Noteri u'a lexoi palëve aktin noterial në prani të tyre dhe pasi që është siguruar se përmbajtja i përgjigjet vullnetit të palëve, palët me vullnetin e tyre të lirë, pa presion, mashtrim apo lajthim të njëjtin akt noterial e pranojnë dhe si rrjedhojë me dorë të vetë e nënshkruajnë, kurse pas tyre e nënshkruan edhe noteri.-----

12.2. Shpenzimet e këtij akti notrial (taksat, shërbimet dhe harxhimet e zyrës së noterit) do të jenë në ngarkesë të qiramarrësit në shumë prej 80.00 +10%+2,00 (20x0.10)+0.50(lidhje e aktit) = 90.50 Euro plus 18% TVSH= **106.79 euro**, të përcaktuara me UA NR.02/12 mbi tarifrat, Neni 21.shtojca 1, Neni 40.3 dhe Neni 41.-----

12.3. Veprimi i noterizimit u zhvillua pa ndërprerje dhe në praninë e të gjithë personave në zyren e noterit, më tridhjetë qershor dymijë e njëzet e një(30.06.2021) -----



12.4. Ky akt noterial lëshohet sipas nenit 3, pika 3.1 të Ligjit për Noterinë 03/L-010 dhe përbëhet prej gjashtë (6) fletëve dhe njëmbëdhjetë (11) faqeve.-----

NËNSHKRIMET E PALËVE DHE NOTERIT:-----

QIRADHËNËSIT:-----

1. Luan Likaj përfaqshuar nga Drilon Heta

2. Jetmir Likaj përfaqshuar nga Drilon Heta

QIRAMARRËSI:-----

"MERCHANDISING GROUP" L.L.C., përfaqshuar nga drejtori Drilon Heta



-----NOTER: Ekrem Nuhju-----

